



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 22

Datë: 01. 09. 2022. Ora: 13: 30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Shqyrtimi dhe miratimi Projektit dhe Agjendës së Punëtorisë për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së 2023-2026 (Misioni i KQZ-së, Parimet udhëheqëse, Vizioni i KQZ-së dhe Analiza SËOT) ” dhe

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapi mbledhjen, e kemi një kërkesë nga KOZ. A ka dikush në lidhje me agjendën e mbledhjes ?

Burim Ahmetaj: Për shkak të mungesës së kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Këshillit për Buxhet dhe Financa, do të ishte mirë që shqyrtimi i “buxhetit” për punëtori të trajtohet direkt në KQZ.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratimin e agjendës ?

Miratohet me 8 vota...

Alim Rama: KOZ-i e ka trajtua planin për hartimin e projektit strategjik. E keni në dokument qëllimin e këtij projekti, objektivat. Në dokument janë paraparë misioni, parimet udhëheqëse, vizioni i KQZ dhe analiza e Sëot. Janë parapa tre ditë të punëtorisë, dhe Sekretariati mendon të mbahet jashtë Kosovës.

Sami Kurteshi: Pse jashtë Kosovës, për shkak të çmimit apo pse ? Kemi vende edhe në Kosovë, dhe janë 28 pjesëmarrës. Mendoj që, personat që punojnë këtu, që janë pjesë e strategjisë është mirë të marrin pjesë. Unë jam kundër pjesëmarrjes së madhe, por ky është dokument dhe kishte qenë mirë me marrë pjesë më shumë se kaq...

Kërkesa ime kishte me qenë me marrë pjesë stafi që punon, i kemi përjashtuar punëtorët e komunave, prandaj këta kanë mu marrë me implementue strategjinë...

Burim Ahmetaj: Nga kjo punëtori, ne e fillojmë hartimin e “dokumentit” dhe me atë, do të punojmë...Ne, kemi marrë për bazë vendimin e KQZ-së, dhe ndoshta do duhej të rritet numri i pjesëmarrësve...

Sami Hamiti: Kjo, ishte edhe ajo që është diskutuar në KOZ ! Unë, mendoj që pjesëmarrësit le të jenë funksional. Herën e fundit, ishin 5 zyrtarë të cilët, fare nuk ishin aktiv, nuk kanë folur fare dhe askush si ka ndaluar...! Si të vendosni, por le të vijnë njerëzit që punojnë, angazhohen...

Arianit Elshani: Po, zyrtarët komunal janë aktiv në takime, kështu që mundet me u rritë numri dhe me një, dy zyrtar komunal si do që ta vlerësoni ju...

Diskutuan edhe: **Alim Rama**, i cili vërejti se mungojnë zyrtarët nga ZRPP, pastaj tha se edhe nga KKZ-të mundën me qenë, por ata që vijnë duhet me qenë aktiv, me dhanë kontribut; Burim Ahmetaj, Sami Kurteshi, Arianit Elshani.

Në fund, anëtarët e KQZ-së vendosën që të rritet numri edhe për 5 pjesëmarrës.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e Projektit dhe Agjendës së Punëtorisë për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ ?

Me 8 vota për miratohet.

Burim Ahmetaj: Buxheti ishte i planifikuar për 28 zyrtar, tani duhet planifikimi për 33 zyrtar. Nga 12 112 euro sa ishin planifikuar, me propozimet që u bënë do të propozohet që të jetë 15 140 euro.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet buxheti i shpenzimeve të punëtorisë.

Per KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
